



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2023:120979

Datë: 11.12.2023

Numri i dokumentit: 05044072

PPP.nr.15/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Pajtesë Boshnjaku, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit M.M.P.H dhe I, I të M, M dhe U, kundër debitorit “A.B” SH.P.K me adresë në Rrugën “Dëshmorët D.” I., nga baza juridike borxh, vlera 5.000.00 Euro, jashtë seance, me datë 11.12.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I.** Gjykata Themelore në Pejë - Dega në Istog, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas prapësimit të debitorit “A.B” SH.P.K me adresë në Rrugën “Dëshmorët D.” Istog lidhur me çështjen borxh, vlera 5,000.00 Euro.
- II.** Pasi që ky aktvendim të merr formë të prerë, lënda i dërgohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë.

A r s y e t i m

Debitori “Ar Beton” SH.P.K me adresë në Rrugën “Dëshmorët D.” I., në Gjykatën Themelore në Pejë-Dega në Istog, me datën 24.04.2023 ka ushtruar prapësim kundër urdhrit përmbartimor, P.nr.86/23 i lejuar nga përmbartuesi privat Jeton Krasniqi, kundër kreditorit M.M.P.H dhe I, I të M, M dhe U,, për borxh, vlera e kontestit 5.000.00 Euro.

Gjykata, në vlerësim të kompetencës lëndore, në bazë të Ligjit Nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, të datës 21 janar 2022, përkatësisht neni 13, paragrafi 1, pika 1.1 në të cilin përcaktohet se “*Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre*”, vlerësoi se për të vendosur në këtë çështje juridike kompetente në pikëpamje lëndore është Gjykata Komerciale në Prishtinë.

Andaj, në rastin konkret, bazuar në provat në shkresat e lëndës, Gjykata ka vlerësuar se në këtë çështje përmbartimore kemi të bëjmë me subjekte juridike, për çka u shpall jokompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas prapësimit e parashtruar nga debitori.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA NË ISTOG, Departamenti i
Përgjithshëm, PPP.nr.15/23, me datën 11.12.2023**

G j y q t a r j a
Pajtesë Boshnjaku

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa
në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit,
Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.